

V E N D I M
Nr. 300, datë 12.5.2001

**PËR PAGESËN E VLERËS SË TRUALLIT TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE PËR
NDËRTIMIN E APARTAMENTEVE PËR KREDITORËT QË KANË HUMBUR BANESAT
NGA RËNIA E SKEMAVE PIRAMIDALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes, të ligjit nr. 8386, datë 30.7.1998 “Për mënyrën dhe procedurën e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” dhe në zbatim të pikës 3 të vendimit nr. 37, datë 21.1.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për mbylljen e llogarive të ish-fondacionit “Demokracia Popullore Xhaferi” dhe kalimin e fondeve të mbetura për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët e skemave piramidale”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Destinacioni i përdorimit të fondeve financiare të mbetura, në Bankën Kombëtare Tregtare, në llogarinë për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale, pas rakordimeve dhe shlyerjeve të detyrimeve, që më 31.3.2001, rezulton 324 000 000 (treqind e njetzet e katër milion) lekë, të jetë:

11 milionë lekë për shlyerjen e detyrimeve ndaj Bankës Kombëtare Tregtare, prej të cilave 6 milionë lekë për rritje detyrimi ndaj kreditorëve, 3 milion lekë për mbulimin e shpenzimeve të kryera dhe 2 milionë lekë fond rezervë, me kusht kthimi.

313 milionë lekë për blerjen e trojeve, për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale dhe për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe kanalizimeve.

2. Ndërtimin nga Bashkia e Tiranës, të apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale, në një sipërfaqe prej 24 360 m², përfshi dhe tri banesat në ndërtim, në zonën e Laprakës, pasuri e shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim.

3. Ndërtimin nga Bashkia e Vlorës të apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale, në një sipërfaqe trualli prej 17 400 m² të objektit ish-frigoriferi, Vlorë, me aksionerë 51 për qind shoqërinë “Cenaj”sh.p.k., në administrim dhe 49 për qind aksionerët e tjerë të saj, ish punonjës të ndërmarrjes.

4.Shuma e fondeve të mbetura, prej 313 milionë lekësh në llogarinë për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale të përdoret:

86 milionë lekë, për pagesën e vlerës së objektit “Kompleksi i banesave, Laprakë”, së bashku me truallin, shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k. në administrim;

69 milionë lekë për pagesën e aksionerëve të objektit ish-frigoriferi, Vlorë.

5. Sipërfaqet e trojeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, së bashku me tri banesat në ndërtim, në zonën Laprakë, të kalojnë në administrim të Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkise së Tiranës dhe asaj të Vlorës, si sheshe të lira për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët e skemave piramidale nga Fondi i Kredisë Greke për Strehim.

6. Makineritë, pajisjet dhe baza tjetër materiale që do të përfitohet pas shembjes së ngrehinave të objektit ish-frigoriferi, Vlorë, të administrohet, prej administratorëve të shoqërisë “Cenaj&Co”, sh.p.k., për shitje, dhe kjo vlerë financiare t’u shpërndahet aksionerëve, përkatësisht 51 dhe 49 për qind.

7. Aksionerët që përfaqësojnë 49 për qind të shoqërisë aksionere të ish frigoriferit, Vlorë, të likujdohen nga administratorët e shoqërisë “Cenaj &Co”, sh.p.k. në administrim, me vlerën e aksioneve që rezulton nga llogaritja e të ardhurave të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, sipas regjistrimit të secilit në regjistrin e aksioneve.

8. Degët e Bankës Kombëtare Tregtare, në Tiranë, Vlorë, për objektet dhe vlerat financiare të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi, në mbështetje dhe të vendimeve të administratorëve, të kryejnë, pranë Bankës së Kursimeve, dega Tiranë, kalimin e shumave në llogaritë për shlyerjen e kreditorëve të shoqërive “Vefa Holding” dhe “Cenaj &Co”, sh.p.k. në administrim.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, grupi Mbikëqyrës dhe administratorët e shoqërive

huamarrëse, subjekte të kontrollit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta